



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 305 / Prot

Tiranë, më 23 / 3 / 2016

**Lënda:** Jepet mendim për përpunimin e të dhënave personale të punonjësve.

**Drejtuar:** **Z. Engjëll AGAÇI**  
**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**  
**KRYEMINISTRIA**

Tiranë

I nderuar z. Agaçi,

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 1301 Prot, datë 25.02.2016, Komisioni Hetimor Parlamentar në cilësinë e kontrolluesit (Kuvendi) në kuptim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, kërkon të përpunojë të dhënat personale të punonjësve të emëruar ose larguar nga administrata gjatë periudhës 15 shtator 2013 deri në 20 shtator 2015.

Në zbatim të Kreut I, të VKM-së nr. 117, datë 05.03.2014 "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit", institucionet e administratës shtetërore krijojnë dhe administrojnë dosjen e personelit të çdo të punësuar në institucionin e tyre.

Lidhja 1 dhe 2 e VKM-së nr. 117, datë 05.03.2014, përcakton të dhënat personale që përmban dosja e personelit/dosja teknike e nëpunësit.

Rrethi i kategorive që njihen me këto dosje dhe për rrjedhojë që përpunojnë të dhëna personale është parashikuar në pikën 5 të Kreut I të Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014. Përveç përcaktimeve konkrete në këtë dispozitë, sa i përket personave apo institucioneve që kanë të drejtë të njihen me dosjet, është parashikuar se një atribut të tillë e ka edhe çdo institucion i ngarkuar me ligj.

Neni 5/1/b i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, në të cilin shprehimisht citohet "...të dhënat personale duhet të grumbullohen për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime", kërkon që përpunimi i të dhënave personale të administruara në dosjet personale të punonjësve të kryhet në përputhje me qëllimin për të cilin ato janë mbledhur dhe nga kategori të caktuara. Kjo nënkupton se përpunimi është kryer apo kryhet për marrëdhënien kontraktore të krijuar midis punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Transmetimi i të dhënave tek një kontrollues tjetër, siç është Komisioni Hetimor Parlamentar, për të përpunuar sipas pikës 5 të Kreut I të Vendimit nr.117, datë 05.03.2014, kërkon që ky i fundit të përcaktojë qëllimin e përpunimit si dhe të dhënat e nevojshme që kërkohet të merren për përmbushjen e qëllimit.

Në përputhje me këtë kërkesë ligjore, Komisioni Hetimor Parlamentar ka përcaktuar qëllimin e përpunimit të të dhënave dhe konkretisht "Verifikimin e ligjshmërisë së emërimeve në detyrë në administratën shtetërore, entet publike apo shoqëritë tregtare shtetërore për periudhën shtator 2013 deri në 20 shtator 2015", por në kërkesë kërkon opinion ligjor lidhur me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënës personale "vendlindje" duke e trajtuar si një të dhënë që nuk përpunohet në dosjet e punonjësve.

Në analizë të kësaj kërkesë specifike vërehet se lidhja 1, e pikës 3, shkronja "a" të VKM-së nr. 117, datë 05.03.2014, ka përcaktuar se dosja teknike e nëpunësit përmban edhe çertifikatën e gjendjes familjare. Për rrjedhojë ky dokument në një rubrikë të veçantë pasqyron edhe vendlindjen e nëpunësit, rezultat i të cilës është edhe përpunimi i kësaj të dhëne.

Në kushtet kur Komisioni Hetimor Parlamentar kërkon të marrë dhe përpunojë këtë të dhënë nëpërmjet organeve të administratës shtetërore si administrues të dosjeve të nëpunësve, është i detyruar të provojë përpunimin e kësaj të dhëne në përputhje me qëllimin që kërkon të përmbushë.

Argumenti i lartpërmendur imponohet nga fakti se të dhënat e mbledhura për punonjësit janë në funksion të përmbushjes së qëllimit reciprok mes këtyre të fundit si punëmarrës dhe administratës si punëdhënës dhe më tej çdo përhapje e tyre e realizuar në përputhje me nenin 18/3/b të ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, do të nënkuptojë përpunim të drejtë e të ligjshëm të të dhënave vetëm nëse e dhëna apo sasi të tyre përputhen me qëllimin e kërkuar për tu realizuar.

Pas këtij ligjërimi, në analizë të tërësisë së përpunimit të të dhënave kur nevojitet tejkalim në mbledhjen e tyre, çdo kontrollues në përputhje me pikën 1 dhe 2 të nenit 18 të ligjit për

mbrojtjen të dhënave personale është i detyruar të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat, për mënyrën e përpunimit, për të drejtën për akses si dhe nëse dhënia e të dhënave është e detyrueshme apo vullnetare, etj.

Gjithashtu, nëse gjatë procesit të verifikimit të dosjeve, Komisioni do të përpunojë të dhëna sensitive si vërtetim të gjendjes gjyqësore, raport mjekësor apo të dhëna të tjera në përputhje me përkufizimin “e dhënë sensitive” dhe nëse në përfundim të procesit të verifikimit të dosjeve, kontrolluesi vlerëson bërjen publike të tyre, atëherë ai më parë, në përputhje me parashikimin e bërë në nenin 7/2/c të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, duhet të paraqesë kërkesë për autorizim pranë autoritetit përgjegjës, në këtë rast pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në përfundim, Komisioni gjatë gjithë procesit të verifikimit duhet të ruajë karakterin konfidencial të dosjeve, ndërsa rasti përjashtimor do të vijë si pasojë e prevalimit të interesit të rëndësishëm publik duke rithëksuar, vetëm pas pajisjes me autorizimin përkatës.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Besnik DERYISHI  
  
KOMISIONERI  
